



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.09.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Ridvan Hado* (anëtar)
5. *Alban Toro* (anëtar)
6. *Marçela Shehu* (anëtare)
7. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Dritan Hallunaj* dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Luan Dibra, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

2. Maela Alicanaj, Këshilltare ligjore pranë Njesisë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3 Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”.¹

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së sotshme lidhet me caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kërkesën e ardhur nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, kërkesë me karakter tepër urgjent paraqitur më datë 27.09.2022. Objekti i kërkesës është shuarje mase sigurimi, afati i të cilës llogaritet me orë.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, duke përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Sqarim nga zoti Kurushi: Gjyqtari që do të përzgjidhet për këtë çështje do të jetë edhe gjyqtari i çështjes së themelit të çështjes penale. Trupi gjykues i cili ka marrë në shqyrtim këtë

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

çështje gjyqësore themeli që ka për objekt akuzën e “Ndhmës së paligjshme të kufirit” aktualisht përbëhet nga dy gjyqtarë. Kërkesa e urgjencës ka ardhur për shqyrtimin e masës së sigurimit, pra e një kërkesë që ka për shqyrtim “Shuarjen e masës së sigurimit”. Meqenëse ndodhet në fazën e gjykimit kjo çështje në gjykatën e apelit, trupi gjykues që gjykon në kohë urgjent masën e sigurimit, ka në kompetencë funksionale për të shqyrtuar edhe çështjen në themel. Ndodhur në këto kushte, propozohet që meqenëse trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Gjirokastër aktualisht përbëhet nga dy gjyqtarë, gjyqtari i ri rishtazi që do të përzgjidhet me short, për të gjykuar kërkesën e urgjencës që ka për objekt “Shuarjen e masës së sigurimit”, propozohet të jetë edhe gjyqtari që do të plotësojë treshen e trupit gjykues që do të gjykojë çështjen e themelit me akuzë “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Adelajda Gjuzi (me sqarimin që zonja Gjuzi do jetë pjesë e gjykimit si për çështjen që ka për objekt “Shuarjen e masës së sigurimit”, ashtu edhe për çështjen penale të themelit, pasi trupi gjykues që gjykon themelin e çështjes ka kompetencë funksionale për të gjykuar edhe kërkesat me natyrë urgjente.

Pas hedhjes së shortit mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor